

Në bazë të nenit 13 paragrafi (1) të Ligjit për Qendrën Shtetërore të Provimeve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 235/24) dhe nenit 5 paragrafi 1 i Rregullores për mënyrën, procedurën dhe kriteret për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe përcaktimin e masës së kompensimeve autoriale dhe kompensimeve për shërbime të tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr. 01-440/3 të datës 28.12.2022, nr. 01-176/3 të datës 1.3.2023 nr. 01-197/3 të datës 15.4.2024 dhe nr. 01-109/3 të datës 11.2.2025, dhe në lidhje me nenin 2, paragrafin 15 të Ligjit për mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat fillore dhe të mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19) dhe Rregulloren për programin për dhënie të provimit profesional të mësimdhënësit – praktikant dhe bashkëpunëtorit profesional – praktikant dhe mënyrën e realizimit të provimit profesional ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 121/20), Qendra Shtetërore e Provimeve Shkup publikon

KONKURS PUBLIK

për zgjedhjen e kryetarëve dhe zëvendëskryetarëve të komisioneve të ekspertëve

I. Qendra Shtetërore e Provimeve shpall konkurs publik për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm - kryetarë dhe zëvendëskryetarë të komisioneve të ekspertëve për zbatimin e provimit të praktikantit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional nga shkollat fillore dhe të mesme, për:

1. **GJUHË DHE LETËRSI MAQEDONASE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën maqedonase.
2. **GJUHË SHQIPE dhe GJUHË DHE LETËRSI SHQIPE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën shqipe.
3. **GJUHË TURKE dhe GJUHË DHE LETËRSI TURKE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën turke.
4. **GJUHË DHE KULTURË SERBE, ROME, BOSHNJAKE, VILLEHE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën serbe/rome/boshnjake ose vllehe.
5. **MËSIMDHËNËS TË MËSIMIT KLASOR NË GJUHËN MAQEDONASE** - katër bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën maqedonase.
6. **MËSIMDHËNËS TË MËSIMIT KLASOR NË GJUHËN SHQIPE** - katër bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën shqipe.
7. **MËSIMDHËNËS TË MËSIMIT KLASOR NË GJUHËN TURKE** - dy bashkëpunëtorë të jashtëm për mësim në gjuhën turke.

Dy bashkëpunëtorë të jashtëm (një në gjuhën maqedonase dhe një në gjuhën shqipe) për secilën nga lëndët ose profesionet/sectorët:

8. MATEMATIKË; 9. SHKENCA KOMPJUTERIKE; 10. FIZIKË; 11. KIMI dhe SHKENCA NATYRORE; 12. BIOLOGJI; 13. GJEOGRAFI; 14. HISTORI; 15. SOCIOLOGJI, SOCIOLOGËT, PUNONJËSIT SOCIAL, EDUKIMI QYTETAR dhe KULTURA QYTETARE; 16. NJOHJE TË RELIGJIONEVE, ETIKA E RELIGJIONEVE, ETIKË dhe PAQE DHE TOLERANCË; 17. FILOZOFI, LOGJIKË, ESTETIKË; 18. KULTURA KLASIKE E CIVILIZIMIT EVROPIAN dhe GJUHË LATINE;
 19. GJUHË ANGLEZE; 20. GJUHË FRËNGE; 21. GJUHË GJERMANE; 22. ARSIM TEKNIK; 23. ARTI FIGURATIV, ARSIM FIGURATIV, ARSIM ARTISTIK – ARTI FIGURATIV DHE DIZAJNIM dhe GRAFIK; 24. ART MUZIKOR, EDUKIM MUZIKOR, EDUKIM ARTISTIK – ART MUZIKOR DHE BALET; 25. PSIKOLOGJI dhe PSIKOLOGË; 26. PEDAGOGJI dhe PEDAGOGË; 27. EDUKATOR SPECIAL (DEFEKTOLOGË, LOGOPEDË); 28. BIBLIOTEKIST; 29. PROFESIONI/SEKTORI: SHËNDETËSOR/SHËNDETËSI DHE MBROJTJE SOCIALE dhe PROMOVIMI I SHËNDETIT PUBLIK;
 30. PROFESIONI/SEKTORI: KATERING DHE TURIZMI / KATERING DHE TURIZMI;
 31. PROFESIONI/SEKTORI: BUJQËSI-VETERINARI/ BUJQËSI, PESHKATI DHE VETERINARI; 32. PROFESIONI/SEKTORI: KIMIKO-TEKNOLOGJIKE/KIMI DHE TEKNOLOGJI;
 33. PROFESIONI/SEKTORI: TEKSTILE DHE LËKURË/TEKSTILE, LËKURË DHE PRODUKTET TË NGJASHME;
 34. PROFESIONI/SEKTORI: TRAFIK/KOMUNIKACION, TRANSPORT DHE DEPONIM;
 35. PROFESIONI/SEKTORI: MEKANIKE / INXHINIERI MEKANIKE; 36. PROFESIONI/SEKTORI: ELEKTROINXHINJERI/ELEKTROINXHINIERI; 37. PROFESIONI/SEKTORI: EKONOMIKO-JURIDIK DHE TREGTI/EKONOMIK, DREJTËSI DHE TREGTI dhe INOVACION; 38. PROFESIONI/SEKTORI: NDËRTIM DHE GJEODETIKA/ NDËRTIM DHE GJEODETIKË; 39. PROFESIONI/SEKTORI: SHËRBIMET PERSONALE
- Dy bashkëpunëtorë të jashtëm (për mësim në gjuhën maqedonase) për secilën nga lëndët ose profesionet/sectorët:
40. GJUHË ITALIANE; 41. PROFESIONI/SEKTORI: PYLLTARI DHE PËRPUNIM DRURI/PYLLTARI DHE PËRPUNIM DRURI; 42. PROFESIONI/SEKTORI: GJEOLGJIKO-XEHETARI DHE METALURGJI/GJEOLGJI, XEHETARI DHE METALURGJI;
 43. EDUKATË FIZIKE DHE SHËNDETËSORE - katër bashkëpunëtorë të jashtëm (dy në gjuhën maqedonase dhe dy në gjuhën shqipe).

II. Kushtet që duhet të plotësojnë kandidatët dhe dokumentacioni i detyrueshëm që duhet të dorëzojnë:

Kandidatët që konkurrojnë për **kryetarë dhe zëvendëskryetarë** të komisioneve të ekspertëve për zhvillimin e provimit të praktikantit duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të ketë kryer të paktën studimet akademike të ciklit të parë në lëndën përkatëse, pra profesionin/sectorin përkatës;
- të jetë mësimdhënës i lëndës/profesionit/sectorit përkatës në shkollat fillore/të mesme në RMV;
- të ketë të paktën 7 vjet përvojë pune në një institucion edukativo-arsimor të verifikuar dhe/ose mësimdhënës nga institucione të arsimit të lartë të akredituar në fushën përkatëse, preferohen kandidatët me përvojë si mentor ndaj praktikantit;

Kandidatëve u kërkohet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

- fletëparaqitje e plotësuar (formulari i paraqitjes është i postuar në faqen e internetit: www.dic.edu.mk);
- një kopje të noterizuar të certifikatës/diplomës së arsimit të lartë përkatës;
- vërtetim origjinal për punësim të rregullt dhe përvojë pune të përshtatshme prej së paku 7 vjet si mësimdhënës/bashkëpunëtor profesional në veprimtari edukativo-arsimore, të lëshuar nga shkollat fillore/të mesme në RMV;
- Dëshmi për mentorim të përfunduar (vendim për emërimin si mentor dhe një program për mbështetjen e praktikantit), nëse ka.

III. Qendra Shtetërore e Provimeve do të bëjë përzgjedhjen sipas kritereve të mësipërme dhe nëse në konkurs aplikojnë një numër më i madh kandidatësh sesa kërkohet për një lëndë dhe/ose profesion/sector të caktuar që plotëson kërkesat e konkursit, kandidatët që kanë përvojë të mëparshme si mentorë të praktikantëve do të ftohen në intervistë, pas së cilës do të vijojë përzgjedhja përfundimtare.

IV. Kandidatët të cilët do të zgjidhen kryetarë dhe zëvendëskryetarë të komisioneve të ekspertëve për zhvillimin e provimit të praktikantëve për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional, do të angazhohen në një periudhë prej 4 (katër) seancash provuese (sesione pranverore dhe vjeshtore për vitin 2025 dhe 2026).

V. Afati i fundit për aplikimin e kandidatëve të interesuar është 5 (pesë) ditë pune nga data e publikimit të shpalljes në gazetën ditore.

VI. Dokumentacioni i vonuar, i pavlefshëm dhe i paplotë nuk do të merret parasysh.

VII. Fletëparaqitja me dokumentacionin e kërkuar dorëzohet në Arkivin e Qendrës Shtetërore të Provimeve (nga ora 10:00 deri në ora 14:00) ose me postë rekomandë, në adresën: Qendra Shtetërore e Provimeve - Shkup rr. "Vasil Gjorgov" pn, 1000 Shkup, me shënimin "Për konkurs publik për kryetarë dhe zëvendëskryetarë të komisioneve të ekspertëve për zhvillimin e provimit praktikant".

VIII. Të interesuarit mund të marrin informacion shtesë duke telefonuar në numrin 075/300-606, çdo ditë pune.

QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE